



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT

Nr. _____ prot.

Kamëz, më ____ . ____ . 2025

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Data : 23.07.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik **RAMALLARI sh.p.k**, me NUIS: **L77509201U** me adresë: *Kukes, Lagjja Zona Industriale, Rruga Nacionale Kukes-Krume Km1, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.pasurie 16/86*

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Mall**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e hapur”**

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: **Nr.REF-53442-07-03-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje kontenierë”**

Kohëzgjatja e kontratës: **15 (pesëmbëdhjetë) ditë**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 04.07.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : Nr. 34 datë 07 Korrik 2025,
Faqe 65-66.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. AL - STEEL CONSTRUCTION 01

L82421503K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **15,541,000** (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e një mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. LUAR BROS

L72322004M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **14,478,000** (katërmëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. RAMALLARI

L77509201U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **15,307,886** (pesëmbëdhjetë milion e treqind e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. AL - STEEL CONSTRUCTION 01

L82421503K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **15,541,000** (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e një mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

arsyet e mëposhtme

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DST. Mungesa e mostrës – mungesë përmbushjeje e kriterit teknik Në DST është përcaktuar shprehimisht si kërkesë teknike dhe detyrim formal dorëzimi i një mostre fizike të produktit të ofruar (në këtë rast, kontenierit metalik), brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe me parametra të plotë për verifikim fizik. Operatori ekonomik në fjalë nuk ka dorëzuar mostrën, duke e bërë të pamundur:
 - verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike,
 - testimin dhe inspektimin fizik të materialit, përmasave dhe ndërtimit,
 - garantimin e origjinës dhe cilësisë së mjetit të ofruar.

2. LUAR BROS

L72322004M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **14,478,000** (katërmëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

arsyet e mëposhtme

Autorizimi i prodhuesit:

- Operatori Ekonomik “Luar Bros” sh.p.k ka paraqitur një dokument në sistemin elektronik të prokurimeve publike një autorizim prodhuesi të lëshuar nga shoqëria tregtare “Eternal Metal” SH.P.K, një document që nuk përmban përshkrimin teknik të produkteve të autorizuara, nuk sqarohet në mënyrë të saktë se cilat janë produktet që mbulohen nga autorizimi, përtej një referimi të përgjithshëm “produkte të treguara nga ana jonë”.

- Autorizimi i prodhuesit ka shprehje të pasakta për qëllimin e autorizimit të tilla si “për të negociuar dhe nënshkruar kontratë” që nuk janë në përputhje me natyrën e dokumentit, i cili duhet të vërtetojë vetëm të drejtën për të ofruar produkte të caktuara.
- për mosplotësim të kërkesave të detyrueshme teknike, duke paraqitur një autorizim prodhuesi të pavlefshëm dhe të pasaktë, që nuk siguron qartësisht as statusin e operatorit si distributor i autorizuar, as karakteristikat e produktit të ofruar.

Mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k

Mostra e dorëzuar nuk ishte e prodhuar nga subjekti i autorizuar (“Eternal Metal” sh.p.k.)

Operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k. ka paraqitur një autorizim të supozuar nga kompania “Eternal Metal” sh.p.k., me të cilin pretendon se është distributor ose përfaqësues i autorizuar i këtij prodhuesi. Megjithatë, gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe krahasimit të mostrës së dorëzuar me profilin e aktivitetit të prodhuesit të deklaruar, si dhe mungesës së çdo prove shoqëruese të identifikimit të produktit, konstatohet se:

- Nuk ekziston asnjë element fizik apo dokumentar që të provojë se mostra e dorëzuar është realisht e prodhuar nga “Eternal Metal” sh.p.k.”;
- Në trupin e kontenierit nuk ndodhë asnjë mbishkrim identifikues, asnjë shenjë e brendshme e prodhuesit ose etiketë metalike (nameplate), që të përputhej me emrin e subjektit autorizues;
- Nuk është dorëzuar asnjë deklaratë origjine ose vërtetim që lidhet prodhimi i këtij kontenieri me kompaninë “Eternal Metal”.

Në këto kushte, operatori ekonomik nuk e ka provuar lidhjen reale dhe teknike midis subjektit autorizues dhe produktit të dorëzuar, duke e bërë autorizimin një dokument formal, por jo funksional.

Në mungesë të çdo elementi identifikues që të lidhë kontenierin e dorëzuar me subjektin prodhues të deklaruar në autorizim, nuk garantohet origjina e produktit, për rrjedhojë:

- Nuk verifikohet përputhshmëria me standardin e prodhimit të deklaruar;
- Nuk garantohet cilësia dhe mbështetja teknike pas shitjes;
- Autorizimi konsiderohet i paefektshëm dhe operatori skualifikohet për mungesë të kapaciteteve të kërkuara.

Vlerësimi i mostrës së paraqitur:

Mostra e dorëzuar nuk përputhet me kërkesat teknike të DST-së

Gjatë procesit të dorëzimit dhe verifikimit të mostrës së kontenierit metalik, sipas procesverbalit të përpiluar nga KVO, u konstatua se mostra e paraqitur nuk i përmbush kriteret teknike të përcaktuara në DST, konkretisht:

- Trashësia e trupit metalik rezultoi më e ulët se minimumi teknik i kërkuar (të përcaktuar sipas pikës përkatëse të specifikimeve teknike);

- Nuk ka integrim të plotë të komponentëve metalikë në konstruksion, duke përjashtuar garancinë për qëndrueshmëri strukturore dhe jetëgjatësi;
- Nuk përmbush kriteret për distancën e përcaktuar midis krahëve dhe sipërfaqes bazë të kontenierit, duke ndikuar në sigurinë dhe manovrueshmërinë e mjetit të pastrimit;
- Nuk plotëson kërkesën për volumin efektiv të brendshëm, që është kusht thelbësor për përmbushjen e funksionalitetit të mjetit.

Këto mangësi janë elemente thelbësore teknike dhe përbëjnë mosrespektim të kriterëve minimale të cilësisë të përcaktuara qartë në DST.

Procesverbali i dorëzimit të mostrës me nr. 840 prot., datë 22.07.2025 është nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i operatorit ekonomik “Luar Bros” sh.p.k., sipas autorizimit të protokolluar me nr. 843, datë 21.07.2025. Ky përfaqësues nuk ka paraqitur asnjë vërejtje, kontestim apo sqarim, çka tregon se operatori ekonomik ka qenë plotësisht në dijeni dhe në pajtim me konstatimin se mostra nuk i përmbushte kërkesat teknike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik ekonomik **RAMALLARI**, me NUIS: **L77509201U** me adresë: *Kukes, Lagjja Zona Industriale, Rruga Nacionale Kukes-Krume Km1, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.pasurie 16/86*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera: **15,307,886** (pesëmbëdhjetë milion e treqind e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh totali i pikëve të marra [____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arben LAÇI